

Konventë mbi ndalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit.

New York, 9 dhjetor 1948.

a/ Rezervë për nenin IX. «Republika Popullore e Shqipërisë nuk konsiderohet e lidhur nga dispozitat e nenit IX, që parashikojnë se çdo kontestim që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj konvente do t'i paraqitet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, mendimi i së cilës do të pranohet, si vendimtar nga palët; përsa u takon kompetencave të Gjykatës për çështjet e mosmarrëveshjeve lidhur me interpretimin ose zbatimin e konventës, Republika Popullore e Shqipërisë do të vazhdojë t'i përmbahet qëndrimit siç ka bërë deri më sot, se për çdo rast të veçantë është i nevojshëm pelqimi i të gjitha palëve në mosmarrëveshje që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të shqyrtojë këtë mosmarrëveshje dhe të marrë vendimin përkatës».

b/ Rezervë për nenin XII. «Republika Popullore e Shqipërisë deklaron se nuk i pranon dispozitat e nenit XII-të të konventës dhe mendon se të gjitha klauzolat e kësaj konvente duhet të zbatohen për teritorët jo autonome, duke përfshirë edhe teritorët nën kujdestari».